



REPUBLIKA E SHQIPERISË

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
REKTORATI

DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE DHE JURIDIKE

Prot 611
DT 14.10.2024

Nr. 2543 Prot.

Tiranë, më 14/10/2024

Lënda: Mbi fillimin e procedurave të njoftimit të studentëve për aplikimin dhe dorëzimin e dokumentacionit për përfitimin e bursës financiare dhe përjashtimin/reduktimin nga tarifa vjetore e shkollimit.

FAKULTETIT TË INXHINIERISË MATEMATIKE DHE INXHINIERISË FIZIKE
FAKULTETIT TË ARKITEKTURËS DHE URBANISITIKËS
FAKULTETIT TË TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT
FAKULTETIT TË GJEOLGJISË DHE MINIERAVE
FAKULTETIT TË INXHINIERISË SË NDËRTIMIT
FAKULTETIT TË INXHINIERISË ELEKTRIKE
FAKULTETIT TË INXHINIERISË MEKANIKE

Mbështetur në vendimin nr. 39, datë 23.01.2019 të Këshillit të Ministrave për disa ndryshime në vendimin nr. 903, datë 21.12.2016 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore, për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë”, vendimin nr. 40, datë 23.01.2019 të Këshillit të Ministrave për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 269, datë 29.03.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimi në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit” i ndryshuar, si dhe vendimin nr. 780, datë 26.12.2018 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret për ulje të tarifës vjetore të studimit në programet e ciklit të dytë të studimeve në institucionet publike të arsimit të lartë”, të merren masat për njoftimin e të gjithë studentëve që ndjekin studimet në një program të ciklit të parë, në një program të integruar, si dhe në një program të ciklit të dytë studimeve, që plotësojnë kriteret për përjashtimin/reduktimin nga tarifa vjetore e shkollimit, si dhe kriteret për përfitimin e bursës financiare, për dorëzimin e dokumentacionit që vërteton statusin e tyre.


Për studentët e ciklit të parë që përfitojnë bursë financiare sipas vendimit nr. 903, datë 21.12.2016, afati për dorëzimin e dokumentacionit me qëllim përfitimin e bursës nga fillimi i vitit akademik është data 15.11.2024. Studentët që dorëzojnë dokumentacionin pas kësaj date, do të trajtohen me bursë financiare nga muaji pasardhës i aplikimit.

Lidhur me studentët që ndjekin studimet në një program në ciklin e dytë të studimeve, afati për shqyrtimin dhe miratimin e listës së studentëve që plotësojnë kriteret për reduktimin nga tarifa vjetore e shkollimit, është brenda muajit dhjetor.

Për sa më sipër, të ndiqen procedurat për njoftimin e studentëve në të dyja ciklet e studimit, të cilët përmbushin kriteret e përcaktuara në aktet nënligjore në fuqi për përjashtimin/reduktimin nga tarifa vjetore e shkollimit dhe përfitimin e bursës financiare, si dhe procedurat për mbledhjen e dokumentacionit përkatës që vërteton statusin e tyre.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

ADMINISTRATORI



Besmir Ali